

Vllaznia/ Lojtaret nuk do te festojne nese do ti shenojne Partizanit

nga AlbaniaSoccer

E premte, 25 Tetor 2013 21:39



Te gjithë ne Shkoder jane bere pjese e dhimbjes pas tragjedise qe i mori jeten pese djemve ne nje aksident tragjik pak dite me pare. Per te respektuar tifozet kuqeblu qe nuk jetojne me, lojtaret e Vllaznise pritet te mbajne nje minute heshtje para se te nise ndeshja me Partizanin dhe gjithashtu me kerkesen e grupimit "Vllaznit Ultras" pritet te mos festojne ne rast se do te shenojne ne porten e Partizanit. Nje xhest ky qe duhet vleresuar pas vlen si shenje respekti per tifozet kuqeblu qe nuk jetojne me.